



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Datë: 08.07.2025
Numër Protokolli: 4658/2025

A.nr.801/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari, kryetare, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.801/2025, të datës 05.05.2025, të parashtruar nga ankuesi G.H, kundër organit të punësimit/Ministritsë së Fianncave Punës dhe Transafereve, në çështjen juridike “*kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 08.07.2025, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i filluar sipas ankesës me numër A.nr.801/2025, të datës 05.05.2025, të parashtruar nga ankuesi G.H.

A r s y e t i m

Kandidati për pranim në shërbimin civil G.H(në *tekstin e mëtejme referuar* Ankuesi), më datë 05.05.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër njoftimit të datës 14.04.2025 të Divizionit të Burimeve Njerëzore të Ministritsë së Fianncave Punës dhe Transafereve lidhur me refuzimin e aplikacionit për procedurën e pranimi RN00016974 për pozitën Zyrtar për Administrimin e Dokumenteve në Zyrën Lokal të Pensioneve në Ferizaj.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave, me datë 25.05.2025, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankese në Ministrinë e Fianncave Punës dhe Transafereve (tutje MFPT), ndërsa, kjo e fundit, më datë 17.06.2025, ka përcjell dokumentacionin lidhur me çështjen në procedurë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të parashtruar nga palët në procedurë, ka konstatuar se janë përmbushur kushtet për përfundim të procedimit administrativ të filluar sipas ankesës A.nr.801/2025, sepse:

Nga administrimi i shkresave të lëndës Kolegji i Këshillit, ka gjetur se MFPT, më datë 07.03.2025 ka shpallur konkursin me Nr. Reference RN00016974 për Grupin e Arkiv-Dokumentacionit pozita Zyrtar për Administrimin e Dokumenteve në Zyrën Lokale të Pensioneve në Ferizaj. Tutje sipas Njoftimit të datës 14.04.2025 të Divizionit të Burimeve Njerëzore të MFPT-së, ankuesit i është refuzuar aplikacioni për shkak se i mungon kualifikimi i kërkuar.

Ankuesi më datë 05.05.2025, kundër këtij njoftimi ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet se ka përmbushur kriterin e kualifikimit sepse në konkurs është kërkuar Arsimin i lartë nivelit i parë Bachelor. Kërkon që të përfshihet në listën e ngushtë dhe të vazhdohet tutje.

Derisa ankesa e ankeses ka qenë aktive në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Divizioni i Burimeve Njerëzore i MFPT-së, më datë 29.05.2025 ka nxjerr Vendim me numër protokolli 1656/2025, me të cilin ka bërë anulimin e konkursit Nr. Reference RN00016974 për Grupin e Arkiv-Dokumentacionit pozita Zyrtar për Administrimin e Dokumenteve në Zyrën Lokale të Pensioneve në Ferizaj, me arsyetimin se në fazën verifikimit është vërejtur se ka pasur parregullsi në me rastin e vlerësimit të dokumenteve të një kandidati.

Kolegji i Këshillit, duke marr parasysh faktin se ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka konstatuar njoftimin e datës 14.04.2025 të Divizionit të Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Fianncave Punës dhe Transafereve lidhur me refuzimin e aplikacionit, atëherë me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër protokolli 1656/2025, të datës 29.05.2025 nga Divizioni i Burimeve Njerëzore i MFPT-së, për anulimin e këtij konkursit, është krijuar rrethanë e re juridike, në pikëpamje juridike Kolegji i Këshillit, konstaton se në rasatin konkret nuk mund të shqyrtohet ligjshmëria e njoftimit të datës 14.04.2025 të cilin pala ankuese e ka kontestuar me ankesë, ngase i njëjti nuk ka ndonjë efekt për shkak që konkursi tashmë vetëm është anuluar dhe palët kundër vendimit për anulim të konkursit kanë mundur të parashtrojnë ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e për rrjedhojë mbi bazën e këtyre rrethanave rrjedhë së objekti i ankesës A.nr.801/2025, është bërë i pamundur për shqyrtim dhe vendosje në kuptim të dispozitave të nenit 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative më të cilat është përcaktuar se: *“Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kot”*.

Kështu që, në mbështetje të nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi që të përfundoj procedimin administrativ të filluar me ankesën A.nr.801/2025, të datës 05.05.2025.

Këshillë juridike: Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda: A.nr.801/2025

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Malsore Gashi BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit Guron Haxhimusa;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në MFPT; dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së.